



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED
PREMIJERA

AGJENCIA PER BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST
POLOVA / AGENCY OF GENDER EQUALITY

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister Agjencia për Barazi Gjinore - Agencija za Polnu Ravnopravnost - Agency for Gender Equality
Nr.Prot. Br. Prot. Prot. No.	285 / 2023
Data: Datum: Date:	09.08.2023
	Prishtinë/Priština/Prishtina

Datë:09/08/2023

RAPORT

Implementimi i thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që kontribuojnë në :

Subvencionimin e projekteve për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Hyrje

Agjencia për Barazi Gjinore ka bërë thirrje publike me dt. 22.06.2023, rishpallur prapë me dt.07.07.2023 për financim të projekteve të OJQ-ve në zbatim të drejtpërdrejtë të Objektiva Strategjike, të Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026 dhe planit të tij të veprimit, respektivisht Objektiven IV Sigurimi i shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat, respektivisht:

Objektivi specifik IV.1 Zbatimi i politikave që mundësojnë ri integrim afatgjatë e fuqizim të qëndrueshëm të viktimave/mbijetuarave të dhunës

Veprimi IV 2.9 Subvencionimi i projekteve për fuqizimin ekonomik të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave.

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar këtë thirrje publike duke respektuar standardet me të larta të konkurrencës, transparencës dhe vendimmarrjes në përputhje me rregulloren MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Në kuadër të kësaj thirrje publike Agjencia për Barazi Gjinore ka pranuar aplikimet e gjithsej 10 Organizata Jo Qeveritare të cilat kanë paraqitur projektet e tyre për mbështetje financiare. Lista e të gjithë aplikantëve (OJQ-ve) që kanë aplikuar në kuadër të kësaj thirrje publike.



1. OJQ Ta ruajmë traditën –Promovimi i të drejtave të grave të komunitetit RAE dhe fuqizimi i rolit te tyre në sfidimin e dhunës në familje
2. OJQ PONTIS URA- Ofrimi i mundësive të punësimit për viktimat e dhunës në familje dhe krijimi i mundësive me të qëndrueshme financiare”
3. OJQ ZANA- Riintegrimi i të mbijetuarave të dhunës në familje nëpërmjet fuqizimit ekonomik
4. OJQ Shoqata e prindërve të ndarë- Rruga drejt fuqizimit- Mbështetja e viktimave të dhunës
5. OJQ Lulishtja Dita- Trajnim për mbrojtjen e ambientit përmes teknologjisë
6. OJQ Bussines Women Mitrovica – Rritja e përpjekjeve për riintegrimin e viktimave të trafikimit Mitrovicë
7. OJQ CECD- Friends- Fuqizimi ekonomik i grave dhe vajzave viktimat të dhunës në familje
8. OJQ Mundësia – Fuqizimi ekonomik i grave, investim në mirëqenien e shoqërisë
9. OJQ Dijsa Jonë – Hair Make up profesional- trajnime për të rinjtë e Prishtinës
10. OJQ Avancimi i pozitës të rinisë dhe fëmijëve në Kosovë- Parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

Vlerësimi

Agjencia për Barazi Gjinore ka themeluar Komisionin vlerësues me nr. të vendimit 280/2023 përberë nga 3 zyrtar të ABGJ-së dhe dy anëtar/e përfaqësues nga Shoqëria Civile gjegjësisht ekspert të jashtëm, kishte për detyrë të vlerësoj të gjitha aplikacionet e paraqitura në kuadër të thirrjes publike.


Komisioni Vlerësues i themeluar sipas thirrjes dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017, në prezencë të të gjithë anëtarëve ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe sipas kriterëve të thirrjes publike, dhe kriterëve të rregullores MF-Nr.04/2017, komisioni ka vlerësuar dhe ka ardh në përfundim se asnjë nga aplikantët nuk kanë plotësuar në tërësi kriteret specifike në thirrje dhe në Rregulloren e MF-Nr.04/2017 dhe sipas nenit 17 paragrafit 2 të njëjtat nuk kalojnë fare në fazën e vlerësimit përmbajtësor dhe si të tilla diskualifikohen.

Bazuar në vlerësimin e lartshënuar Komisioni ka vlerësuar se nuk ka bazë për mbështetje financiare dhe rekomandon që ABGJ-ja të bëjë ri shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve.

Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Komisionin për ankese për subvencione në ABGJ në afatin prej 5 (pesë) dite nga data e publikimit. Ankesat duhet të dërgohen në kopje fizike në zyrat e Agjencisë për Barazi Gjinore, kati VII Ndërtesa e Qeverisë, sheshi Skënderbe.

Anëtarët e Komisioni

Shpresa Zariqi - Kryesuese



Jehona Xani -Anëtare



Yllka Kotorri-Anëtare



Arianit Jashari-Anëtar



Merita Shala -Anëtare

